



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të inxhinierisë Minerare
Institucioni	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve
Nr. i Referencës	RN00010347
Kodi	RPC0004037
Data e njoftimit	04.11.2022
Afati për aplikim	25.11.2022 - 02.12.2022



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Inspektimi i aktiviteteve të shfrytëzimit dhe aktiviteteve të veçanta për të konstatuar :
- a) nëse kompania e cila ushtron këto aktivitete posedon Licencë ose Leje,
- b) nëse kompania e cila posedon Licencë ose Leje, a i ushtron aktivitetet në përputhje me Licencën ose Lejen përkatëse, respektivisht me ligjet, rregulloret dhe dispozitat ligjore të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
- Inspektimi i lëndimeve me fatalitet (vdekjeprurëse) - lëndimeve të rënda, dëmtimeve dhe degradimeve të rënda mjedisore ose dëmtimi i pronës.
- Kontrollimi i dokumentacionit teknik dhe pranimet teknike për Leje të aktiviteteve të veçanta
- Inspektimi i rregullt i minierave nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe objekteve për përpunimin dhe pasurimin e lëndës së parë minerale.
- Mbikëqyrja e aplikimit të masave të sigurisë dhe mbrojtjes në punë gjatë aktiviteteve minerare
- Inspektimi i aktiviteteve minerare ilegale dhe ndërmarrja e masave për parandalimin e tyre.
- Mirëmbajtja e rregullt e shënimeve të inspektimeve.
- Koordinimi i inspektimeve me institucionet tjera.
- Inspektimi i fushës para minuese sipas nevojës për të konstatuar përputhshmërinë e parametrave teknikë për minim masiv, në përputhje me kërkesën, terrenin dhe projektin e shfrytëzimit.
- Inspektimi i minimit masiv dhe depove të eksplozivëve dhe marrja e masave parandaluese për minim të sigurt, duke i zbatuar të gjitha masat e sigurisë.
- Inspektimi i alarmeve, intervenimeve dhe certifikimin e anëtareve të çetave të shpëtimit.
- Detyra të tjera – në përputhje me ligjet dhe rregulloret – të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri shumë të mira në aplikimin e programeve Microsoft Office (Word, Excel etj).
 - Njohja e gjuhëve zyrtare në vend, përparësi njohja e gjuhës angleze .
 - Aftësi të mira komunikuese.
 - Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion.
 - Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
 - Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë;
 - Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
 - Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
 - Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
 - Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
 - Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
-

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës
RPC0003688	RN00009975	Inspektor i Minierave	Profesional 1	8	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve	Departamenti i Inspektoratit / Prishtinë

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë



9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- Kandidati duhet të ketë Diplomën Universitare të kualifikimit: Inxhinier i Diplomuar i Xehetarisë - 5 vjeçar ose gradën Master në lëmin e Xehetarisë.
- Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
- Përvoja e punës duhet të përfshijë punën në sektorin minerar. Përvoja e punës, përveç vërtetimit të punësimit duhet dëshmuar edhe me pasqyrën e llogarisë nga Trusti ose Qarkores në fuqi.

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Ska

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.
Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

